



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Lezhë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**Shtojca 12**

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT <sup>1</sup>**  
**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Data 12/06/2024

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “Irisa Kaceli” P/F, me adrese Lagjja “Barbulloje”, Rruga e “Rriles”, Ambjent ne zonen kadastrale nr.3641, numri i pasurise 112/31, Tresh, Zejmen, Lezhe.

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur e Thjeshtuar/ Sherbime.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-04842-05-15-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Sherbimi i mbajtjes nen kontroll te qenve endacake per vitin 2024”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 Muaj nga data e nenshkrimit te kontrates.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “IRISA KACELI” P/F, me Nuis M08317501A dhe me oferte ekonomike 2,249,926 (dy milion e dyqind e dyzet e nente mije e nenteqind e njezet e gjashte) Lek pa TVSH,
2. Operatori Ekonomik “LEONARD HALA” P.F, me Nuis L52407024V dhe me oferte ekonomike 2,410,800 (dy milion e kater qind e dhjete mije e tete qind) Lek pa Tvsh,
3. Operatori Ekonomik “ORNIAD” SH.P.K, me Nuis J68423509H dhe me oferte ekonomike 2,410,000 (dy milion e kater qind e dhjete mije) Lek pa Tvsh,

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

<sup>1</sup> Ky Formular eshte i aplikueshëm nëse ka Ankime

## **I- Operatori Ekonomik “LEONARD HALA” P.F, me Nuis L52407024V,**

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE nuk ploteson kriterin 1/a dhe b, si dhe kriteret 2.2.1 deri ne kriterin 2.3.5 te kushteve te veçanta te kualifikimit, pasi nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokumentacion ne permbushje te ketyre kriterëve.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “LEONARD HALA” P.F, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

**Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “LEONARD HALA” P.F, skualifikohet.**

## **II- Operatori Ekonomik “ORNIAD” SH.P.K, me Nuis J68423509H**

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.1, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës*

*që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

*a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*ose*

*b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në”*

KVO verën se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion që provon shërbimet e ngjashme sipas kërkesës së pikës 2.3.1 të DST-se.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues për shërbimet e ngjashme të realizuar nga ana e tij duke mos përmbushur këto kriter.

Se, dyti nuk plotëson kriterin 1/b dhe kriterin 2.3.2, të kushteve të veçanta të kualifikimit, pasi nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në përmbushje të këtyre kriterëve.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur nën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020

“Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “ORNIAD” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

**Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ORNIAD” SH.P.K, skualifikohet.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “Irisa Kaceli” P/F, me adrese Lagjja “Barbulloje”, Rruga e “Rriles”, Ambjent në zonen kadastrale nr.3641, numri i pasurisë 112/31, Tresh, Zejmen, Lezhe se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 2,249,926 (dy milion e dyqind e dyzet e nente mijë e nenteqind e njezet e gjashtë) Lek pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë zyres së protokollit të Bashkisë Lezhe sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjete) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**KRYETARI**  
**Pjerin NDREU**